

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues, të përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i trupit gjykues, Mirvete A. demi dhe Ramush Ademi, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit Sh. S., nga fshati K. e P., Komuna e K., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,¹ të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati M. M., nga Gj.; i akuzuari S. TH. nga fshati M., Komuna e K., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati B. H., nga Gj.; i akuzuari I. TH. nga fshati M., Komuna e K., për shkak të veprës penale mashtrimi në detyrë, nga neni 426 paragrafi 2 të KPRK, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati Sh. SH. nga Gjilani dhe i akuzuari A. K., nga fshati K. e E., Komuna e K., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi, nga neni 290 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të KPRK, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati A. I., nga Gj., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.nr.280/2012, e datës 31.12.2013, të cilën e përfaqëson prokurori Afrim Shefkiu, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datat 31.03.2015, 30.04.2015, 27.05.2015, 21.07.2015, 15.09.2015 dhe 28.10.2015, më datën 02.11.2015, mori dhe publikisht shpalli këtë aktgjykim, ndërsa më datën 13.11.2015, e përpiloi me shkrim këtë :

AKTGJYKIM

I.

I akuzuari SH. S., nga babai A., nëna Sh., e lindur T., i lindur me ... në fshatin K. e U., Komuna e K., ku dhe jeton, shqiptar, qytetar i Kosovës, i martuar, babë i pesë fëmijëve, magjistër i matematikës, punon si profesor i matematikës, i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka qenë i dënuar më parë për vepra tjera penale, konform nenit 364 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPP,

LIROHET NGA AKUZA

Sepse në muajin Tetor të vitit 2011, në cilësi të ... të Komunës së K., përkatësisht ... i projektit, me numër prokurimit ..., me titull Pastrimi i Lumit "...", ka shpërdorë pozitën zyrtare dhe autorizimin me qëllim që vetit dhe operatorit ekonomik "...” fitues i këtij tenderi t’i sjellë dobi të kundërligjshme pasurore, me rastin e implementimit të punimeve ka lejuar ngritjen e vëllimit të punimeve, ashtu që në vend të shumës të paraparë në paramasë prej 138.248,80 €, është bërë pagesa prej 145.000,00 €, edhe pse ka qenë i detyruar ta mbikëqyrë këtë projekt deri në fund, e këtë nuk e ka bërë dhe me këtë buxhetit të Republikës së Kosovës, i është shkaktuar dëm material në lartësi prej 6.751,20 €,

- me këtë kishte për të kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK.

II.

I akuzuari S. TH. nga babai Z. dhe nëna R., e lindur F., i lindur me ... në fshatin M., Komuna e K., ku dhe jeton, shqiptar, qytetar i Kosovës, i martuar, babë i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e lartë, pensionist, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë nuk ka qenë i dënuar për vepra tjera penale, konform nenit 364 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPP,

LIROHET NGA AKUZA

Sepse në cilësi të ... të zyrës së prokurimit publik në Komunën e K., në muajin ... të vitit 2011, ka shpërdorë pozitën zyrtare dhe autorizimin me qëllim që Operatorit Ekonomik "...”, t’i sjellë dobi të kundërligjshme pasurore, nuk ka ushtruar kontrollin e duhur ndaj organit mbikëqyrës, sipas kontratës me numër prokurimit ..., me titull pastrimin e lumit "...”, e që sipas paramasave të bëra është bërë ngritja e vëllimit të punëve, ashtu që në vend të shumës prej 138.248,80 €, e ka lejuar pagesën prej 145.000,00 €, ku në kundërshtim me autorizimet e tij e ka dëmtuar buxhetin Republikës së Kosovës, për shumën prej 6.751,20 €,

- me këtë kishte për të kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK.

III.

I akuzuari I. TH. nga babai R. dhe nëna A., e lindur K., i lindur me ..., në fshatin M., Komuna e K., ku dhe jeton, shqiptar, qytetar i Kosovës, i martuar, babë i dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin e ndërtimtarisë, menaxher në firmën "...”, në K., i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale, konform nenit 364 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPP,

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

LIROHET NGA AKUZA

Sepse në cilësi të organit mbikëqyrës për punimet sipas projektit për Pastrimin e Lumit "...", me numër të prokurimit ..., sipas kontratës së Komunës së Kamenicës me Operatorin Ekonomik "...", ka shpërdorë pozitën zyrtare-autorizimin, ashtu që me raportet e tij nuk ka paraqitë nevojë shtesë të punimeve, duke u prezantuar në raportet e punimeve rritje të vëllimit të punimeve e cila ka rezultuar me dëmtimin e buxhetit të Republikës së Kosovës për shumën prej 6.751.20 €,

- me këtë kishte për të kryer veprën penale mashtrimi në detyrë, nga neni 426 paragrafi 2 të KPRK.

IV.

I akuzuari A. K., nga babai R. dhe nëna H., e lindur K., i lindur me ... në fshatin K. e E., Komuna e K., ku dhe jeton, shqiptar, qytetar i Kosovës, i martuar, babë i tre fëmijëve, menaxher i Operatorit Ekonomik "...", i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë veprë tjetër penale, konform nenit 364 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPP,

LIROHET NGA AKUZA

Sepse gjatë muajit ... të vitit ..., në K., si pronar i Operatorit Ekonomik "...", fitues i tenderit me numër prokurimit ..., me titull "...", në cilësi të personit përgjegjës ka bërë paraqitje të situacioneve të rreme të punimeve, ashtu që ka bërë rritjen e vëllimit të punimeve në kundërshtim me parallogarinë në paramasë, për çka edhe vetit i ka sjellë dobi të kundërligjshme pasurore për shumën e të hollave prej 6.751,20 €,

- me këtë kishte për të kryer veprën penale keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi, nga neni 290 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të KPRK.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

ARSYETIMI

1. Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarve Sh. S., nga fshati K. e P., Komuna e K., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK; i akuzuari S. TH. nga fshati M., Komuna e K., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK; i akuzuari I. TH. nga fshati M., Komuna e K., për shkak të veprës penale mashtrimi në detyrë, nga neni 426 paragrafi 2 të KPRK dhe i akuzuari A. K., nga fshati K. e E., Komuna e K., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi, nga neni 290 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të KPRK.

Si gjatë shqyrtimit fillestar, ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, të akuzuarit Sh. S., S. TH. I. TH. dhe A. K., nuk e kanë pranuar fajësinë për kryerjen e veprave penale për të cilat janë akuzuar.

Prokurori i shtetit, Afrim Shefkiu, gjatë fjalës përfundimtare, pas përmirësimeve të bëra, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës, duke i propozuar trupit gjykues, që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohen me dënime meritore.

Të akuzuarit Sh. S., S. TH. I. TH. dhe A. K., si dhe mbrojtësit e tyre, avokatët M. M., B. H., Sh. SH. dhe A. I., gjatë fjalës përfundimtare i kanë propozuar trupit gjykues që të akuzuarit të lirohen nga akuza.

2. Konstatimet e trupit gjykues

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 të KPP, trupi gjykues konstatoi këtë gjendje faktike :

- se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari Sh. S., me dashje dhe me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete dhe për Operatorin Ekonomik "...", të ketë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 i KPRK, në mënyrën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi;

- se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari S. TH. me dashje dhe me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për Operatorin Ekonomik "...", të ketë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 i KPRK, në mënyrën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi;

- se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari I. TH. me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, të ketë kryer veprën penale mashtrimi në detyrë, nga neni 426 paragrafi 1 i KPRK, në mënyrën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin III të këtij aktgjykimi dhe

- se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari A. K., me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, të ketë kryer veprën penale mashtrimi në detyrë, nga neni 426 paragrafi 1 i KPRK, në mënyrën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin IV të këtij aktgjykimi.

3. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Gjendjen faktike të lartcekur, trupi gjykues e konstatoi pas administrimit të këtyre provave :

- Dëgjimin e ekspertit financiar R. B.;
- Leximin dhe shikimin e provave materiale, siç janë : Marrëveshja e Mirëkuptimit; Kontrata për pastrimin e Lumit "..."; Ekspertiza ekspertit financiar; urdhër-pagesat, fotografitë dhe shkresat tjera të lëndës; si dhe marrjen në pyetje të akuzuarve Sh. S., S. TH. I. TH. dhe A. K..

3.1. Deklarimi i ekspertit

Eksperti financiar z.R. B., gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se lidhur me tenderin e Pastrimit të Lumit "... ka përpiluar me shkrim një ekspertizë, ku ka përcaktuar lëshimet e pjesëmarrësve përkitazi me këtë tender dhe ka shtuar se mbetet në tërësi pranë kësaj ekspertize. Ofertuesi kompania "... sa i përket këtij tenderi ka ofertuar për shumën prej 138.248.80 Euro dhe mbi këtë bazë, komisioni për vlerësimin e ofertave, ka rekomanduar që i njëjti të shpallet fitues i këtij tenderi. Ndërsa, kontrata në mes të Komunës së Kamenicës dhe Kompanisë "... është lidhur në shumë prej 145.000,00 Euro, që do të thotë se është një diferencë prej 6.7521,20 Euro. Financues i këtij projekti, ka qenë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, mirëpo, me zyrarët e saj nuk ka kontaktuar dhe eksperti nuk kanë dalë në teren për të bërë shikimin e vendit të ngjarjes. I njëjti ka shtuar se tek pika 2 dhe 3 e ekspertizës i ka dhënë sqarimet e nevojshme lidhur me dy situacionet.

Eksperti ka sqaruar se ky rast ka qenë edhe në Organin e Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), i cili ka vendosur lidhur me ankesën e Kompanisë "... ngase paraprakisht tenderi i parë ishte anuluar nga Komuna e Kamenicës, ndërsa pasi rasti ishte kthyer në rishqyrtim, komisioni tjetër, përsëri e ka zgjedh operatorin e njëjtë dhe ndaj një vendimi të tillë nuk ka patur ankesa. Ndërsa, nga ekspertiza financiare të cilën e ka përpiluar eksperti R. B. tek pika 3 e kësaj ekspertize është përshkruar e gjithë rrjedha e procedurës së tenderimit sa i përket tenderit Pastrimi i shtratit të Lumit "... në Kamenicë, ku shihet që Komuna e Kamenicës, më datën 31.05.2011 ka lidhë një Marrëveshje të Mirëkuptimit me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nr...., qëllimi i së cilës ka qenë ReA. zimi i Strategjisë së punësimit përmes programit "Punë publike Kosova 2011", ku me marrëveshje është paraparë edhe financimi i projektit "... në Kamenicë, ndërkohë që për reA. zimin e projektit është paraparë që Ministria të zotoj mjetet për atë projekt në shumë prej 145,000.00 Euro. Më datën 21.07.2011, është shpallur "Njoftimi për kontratë pune" me titull "... në Kamenicë, ku kriter për marrjen e kontratës ka qenë çmimi i ultë i shumës për njësi. Komisioni i vlerësimit i përbërë nga H. R., N. R. dhe A. B., më datën 19.08.2011, kanë përpiluar procesverbA. n në të cilin kanë konstatuar se Operatori ekonomik NTP "... nga fshati K. e E., i plotëson kushtet për tender, ku njëherit ka rekomanduar që t'i jepet këtij Operatori ky tender. Lidhur me rekomandimin e komisionit, me arsyetim se komisioni nuk ka qenë i formuar nga kryetari i komunës, në cilësi të zyrtarit autorizues të projektit, i akuzuari Sh. S., më datën 24.08.2011, ka marrë vendim me të cilin ka urdhëruar anulimin e këtij tenderi dhe ka urdhëruar të bëhet rishpallja e tenderit tjetër. Duke qenë se është anuluar tenderi dhe se për këtë veprim ka patur ankesë të Operatorit Ekonomik në OSHP, nga ana e OSHP-së është zhvilluar procedura e vlerësimit të rregullshmërisë së procedurave të tenderit dhe pas shqyrtimit përkatës nga OSHP-ja, ka rezultuar se nuk duhet të anulohet tenderi, por duhet të vazhdohet me procedurat e vlerësimit dhe përzgjedhjes së operatorit të suksesshëm. ... i Komunës dhe ... i prokurimit me aktin nr. ..., të datës ... e kanë formuar një komision tjetër për rivlerësimin e ofertave në përbërje të M. Th., B. D. dhe Sh. M.. Ky komision pas shqyrtimit të ofertave dhe pas vlerësimit të dokumentacionit të ofertuesve pjesëmarrës, ka rekomanduar se Kompania NTP "... përsëri i plotëson kushtet për t'u shpërblyer me kontratë pune, ngase oferta e tij është më e volitshme për shkak të çmimit më të ulët për njësi. Pas këtij rekomandimi të komisionit të vlerësimit, më datën ...2011 është nënshkruar Kontrata për Pastrimin e shtratit të lumit "... në K., me numër identifikues ..., ku për Komunën e Kamenicës ka nënshkruar ... i zyrës së prokurimit z.S. TH. ndërsa për NTP "... z.A. K.. Lidhur me reA. zimin e këtij projekti, me vendimin nr. ..., i datës ...2011, është formuar Komisioni për kontrollimin dhe pranimin teknik të punëve të kryera, i cili Komision është përbërë nga E. I., Z. Th. dhe L. K.i, nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Ky komision më datën ...2011, e ka përpiluar aktin sipas së cilës ka konstatuar se punët janë kryer sipas dokumentacionit teknik dhe kontratës, ndërkohë që edhe kanë bërë pranimin teknik sipas dokumentacionit teknik (paramasës dhe parallogarisë), duke e bërë edhe verifikimin në teren. Në raportin përfundimtar të përpiluar më datën2011, nga I. TH. dhe Sh. M., është konstatuar se reA. zimi i projektit "... në K., është bërë duke u bazuar në paramasën dhe parallogarinë ekzistuese, si dhe punët e kryera në teren. Pas anA. zës së bërë, eksperti financiar ka dhënë mendimin dhe konstatimin e tij përfundimtar përkitazi me lëshimet e procedurave për reA. zimin e projektit të lartcekur. Sipas tij, çmimi i vendosur në kontratën e punës në shumë prej 145.000,00 Euro është pa mbulesë juridike, ngase si çmim i ofertës së ofertuesit ka qenë shuma prej 138.248,80 Euro, kështu që diferenca prej 6.751,20 Euro, në këtë rast paraqet dëmin e shkaktuar investitorit të projektit, përkatësisht përfitimin pa bazë të Operatorit Ekonomik NTP "... Të implikuar në këtë proces tenderik kanë qenë të akuzuarit Sh. S., në cilësi të ... të projektit dhe personit përgjegjës të Komunës së Kamenicës; S. TH. menaxher i zyrës së prokurimit; I. TH. organ mbikëqyrës i Projektit; E. I., Z. Th., dhe L. K.; anëtarë të Komisionit për pranimit teknik të punëve të kryera dhe A. K., pronar i punëkryersit NTP "...

3.2. Provat materiale

Nga Marrëveshja e Mirëkuptimit e lidhur në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Komunës së Kamenicës, e datës 31.05.2015, shihet se qëllimi i saj është reA. zimi i Strategjisë së Punësimit përmes Programit "Punë Publike Kosova 2011" dhe objektiv i kësaj Marrëveshje ka qenë pastrimi "... në K.. Sipas kësaj Marrëveshje, MPMS do të bëjë transferimin e mjeteve prej 145,000.00 Euro për reA. zimin e këtij Projekti, ku 60 % e mjeteve do të jenë të dedikuara për punëtorët, 70 % e të cilëve duhet të jenë punëtorë nga Zyra e Punësimit.

Nga Kontrata e lidhur në mes të Komunës së Kamenicës dhe NTP "... shihet se lëndë e kësaj Kontrate ka qenë "... në K.. Çmimi i planifikuar i kësaj Kontrate, ka qenë 145,000.00 Euro, ndërsa çmimi i totA. t të ofertës për njësi ka qenë 303.80 Euro. Përmes dy urdhërpaguesave, vërtetohet se është bërë pagesa e çmimit në shumë prej 145,000.00 Euro dhe atë dy herë nga 72,500.00 Euro.

Duke ju referuar ekspertizës financiare të ekspertit R. B. si prova materiale janë administruar dhe dosja e tenderit. Nga shkresat e lëndës, Paneli Shqyrtues i Prokurimit, me vendimin PSH.nr.232/11, të datës 29.09.2011, e kishte aprovuar si

të bazuar ankesën e Operatorit Ekonomik “...” me ç’rast edhe e kishte anuluar vendimin e datës 26.08.2011, të Komunës së Kamenicës, mbi njoftimin e anulimit të aktivitetit të prokurimit “...” në K. Nga Formulari i tenderit dhe Lista e plotë standarde e radhitjes së tenderëve, e datës 05.10.2011, shihet se për tenderin e lartcekur kanë aplikuar pesë tenderues të përgjegjshëm dhe atë :

1. NTP “...”- çmimi i shumës për njësi prej 303.86 Euro;
2. KNPSH “...”- çmimi i shumës për njësi prej 307.28 Euro;
3. “...” SHPK- çmimi i shumës për njësi prej 314.36 Euro;
4. SHPK “...”- çmimi i shumës për njësi prej 422.35 Euro dhe
5. “...” - çmimi i shumës për njësi prej 455.59 Euro.

Nga dokumenti i lartcekur, shihet se kriter për dhënien e kontratës ka qenë çmimi më i ulët për njësi dhe duke u bazuar në këtë kriter, Komisioni i vlerësimit të tenderëve, i përbërë prej M. Th., B. D. dhe Sh. M., përsëri e kishin rekomanduar që ofertuesi NTP “...” të shpërblehet me kontratë.

Nga Raporti përfundimtar i Organit Mbikëqyrës, i cili përbehej prej z.I. Th. dhe z.Sh. M., shihet se ishte njoftuar Zyra e Prokurimit e Komunës së Kamenicës, që Operatori ekonomik ‘...’, i kishte kryer punët sipas paramasës dhe parallogarisë, me ç’rast edhe ishte rekomanduar që t’i bëhet pagesa përfundimtare. Kurse, nga procesverbA. i Komisionit për kontrollimin dhe pranimin teknik, të përbërë prej E. I., Z. Th. dhe L. K., shihet se ky Komision ka konstatuar se punimet janë kryer sipas kërkesave në dokumentacionin teknik dhe kontratës. Ku si rezultat i kësaj, edhe është bërë pranimi teknik sipas dokumentacionit teknik (paramasës dhe parallogarisë), duke e bërë edhe verifikimin në teren (vendin e ngjarjes).

Nga fotografitë që gjenden në shkresa të lëndës, shihet se një pjesë e vendit të ngjarjes, përkatësisht shtrati i lumit para dhe pas pastrimit, gjithashtu shihen edhe punëtorët duke punuar, si dhe disa ekskavatorë.

3.3. Deklarimi i të akuzuarve

3.3.1. I akuzuari Sh. S., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor e ka mohuar kryerjen e kësaj veprë penale për të cilën akuzohet, duke shtuar e ka parë të arsyeshme që të bëjë pastrimin e “...” në K., me ç’rast për ta reA. zuar këtë projekt ka aplikuar në Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, ku me këtë Ministri edhe e ka nënshkruar një Marrëveshje të Mirëkuptimit, në vlerë prej 145.000,00 Euro. Pas kësaj, e ka autorizuar z.S. TH. për t’i zhvilluar procedurat e prokurimit dhe ka caktuar edhe organin mbikëqyrës, i cili ka qenë i kontraktuar nga ana e Komunës së Kamenicës, ku përgjegjës i këtij organi, ka qenë Sh. M., i cili më pastaj në organin mbikëqyrës e ka caktuar edhe I. TH.n. Detyrë e këtij organi mbikëqyrës ka qenë përcjellja e punëve të projektit konform kontratës dhe standardeve të punës. Pasi që kanë filluar punët ka dalur në teren dhe ka parë se është duke u punuar mirë dhe se po bëhet një dallim i madh në mes gjendjes së lumit që ka qenë më parë. Në fund të kryerjes së punimeve, është caktuar një komision për kontrollimin e punimeve në përbërje prej E. I., Z. Th. dhe L. K., të cilët e kanë përpiluar raportin, ku kanë konstatuar që punët janë duke u zhvilluar në nivel. Arsyeja pse tenderi është shpallur në njësi e jo me vlera fikse është se shtrati i lumit në Kamenicë është një gjatësie e madhe nga Kamenica e deri në fshatin Berivojcë dhe qëllimi ka qenë që të shfrytëzohet ky buxhet në shumë prej 145.000,00 Euro, për shkak se po të kishte buxhet më shumë, atëherë do të ishte punuar më gjatë se gjatësia ekzistuese e pastrimit të lumit. Nuk ka patur kurrfarë qëllimi të përfitimit për vete e as për punë kryerësin. Sa i përket këtij rasti, i njëjti ka shtuar nuk ka qenë aprovues i mjeteve për pagesë dhe një gjë të tillë e ka bërë MPMS, duke u bazuar në raportin që e ka sjellë organi mbikëqyrës dhe zyra e prokurimit.

Në fund, i akuzuari Sh. S., ka shtuar se me të akuzuarin A. K.n nuk kanë kurrfarë lidhje familjare ose shoqërore, si dhe e ka mohuar faktin se ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim që vetes ose operatorit “...” t’i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme.

3.3.2. I akuzuari S. TH. gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor e ka mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar, duke shtuar se përgjegjësi e tij, si menaxher i zyrës së prokurimit, ka qenë mbikëqyrja e zbatimit të ligjit të prokurimit, nga fillimi e deri në përfundim të projektit të lartcekur. Pasi që ishte autorizuar nga Kryetari i Komunës së Kamenicës, ishte shpallur tenderi, ku ishin kryer të gjitha procedurat e prokurimit dhe OSHP nuk ka bërë asnjë vërejtje se ka patur shkelje të procedurave të prokurimit. Në asnjë nen të ligjit të prokurimit, nuk është paraparë që menaxheri i zyrës së prokurimit, duhet të kontrollojë organin mbikëqyrës. I njëjti ka shtuar se e ka nënshkruar kontratën për kryerjen e punimeve me Kompaninë “...” dhe te ky tender ka patur çmim për njësi e jo për çmim për total. Gjithashtu, edhe ofertuesi që është shpallur më i suksesshëm ka ofertuar me çmim për njësi e jo për me çmim për total, siç e ka cekur eksperti R. B.. Shuma e çmimit të njërive nga ana e ofertuesve tjerë ka qenë më e madhe se sa e ofertuesit NTP “...” Z.L. K. dhe përfaqësuesi ndërkombëtar i Bankës Botërore kanë qenë në zyrën e të akuzuarit S. TH. dhe të njëjtit i kanë thënë që ky është projekti më i mirë që është reA. zuar në vitin 2011 në të gjitha Komunitatet e Kosovës. Pastrimi i shtratit të lumit nuk ka qenë projekt i kufizuar dhe ka qenë projekt në njësi, kështu që sa kanë patur para, aq edhe i kanë reA. zuar punimet. Shuma prej 145.000,00 Euro, është vlera e paraparë e kontratës, e jo siç ka thënë eksperti vlera e kontratës e ofertuesit fitues. Një gjë e tillë është paraparë edhe në kontratën ku është paraparë që kemi çmim të planifikuar të kontratës e jo çmimin fikse. Nuk kanë ndonjë vërejtje as nga kryetari i komunës, si menaxher i projektit, as nga organi mbikëqyrës, e as nga komisioni për pranim dhe kontrollim të punëve. Me pronarin e Kompanisë “...” ne nuk ka kurrfarë lidhje shoqërore ose familjare. Projekti për pastrimin e këtij lumi ka qenë me karakter punësimi, çka d.m.th. se kompania e cila do ta fitonte tenderit ka qenë e detyruar që t’i pranojë në punë punëtorët të cilët kanë qenë në regjistrin e ndihmave sociale dhe këto të holla i kanë përfituar këta persona. Shuma prej 6.751,00 Euro, që është cekur në dispozitivin e aktakuzës nuk është e vërtetë se është dëmtuar buxheti i Republikës së Kosovës, për shkak se MPMS, ka përfituar nga ky projekt, ngase personat që kanë punuar janë privuar nga e drejta e përfitimit të ndihmave sociale, për kohën që kanë punuar në këtë projekt. Kur është shpallur tenderi, zyrtarët e MPMS-së, ka thënë që mirë keni bërë që tenderin e keni shpallur për njësi dhe mund ti shfrytëzoni mjetet për kryerjen e këtij projekti pa kërkuar punë shtesë. Meqë çmimet kanë qenë vetëm për njësi, atëherë edhe organi mbikëqyrës nuk ka patur nevojë për me paraqitë kërkesë për punime shtesë dhe gojarisht ka dëgjuar se operatori “...” ka kryer edhe më tepër punë se sa që kanë qenë të parashikuara me projekt, mirëpo me shkrim nuk ka pasur diçka të tillë.

3.3.3. I akuzuari I. TH. gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor e ka mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se detyrë e tij si mbikëqyrës i projektit, ka qenë mbikëqyrja e ekzekutimeve të punimeve nga ana e punëkryesit, përcjellja e paramasës dhe paralogarisë, si dhe mbikëqyrja e punëve tjera lidhur me këtë projekt. Projekti në këtë rast ka qenë në njësi e që këto njësi nuk e kanë kaluar vlerën e çmimit të përgjithshëm që ka qenë 145.000,00 Euro në bazë të kontratës. Të gjitha punët që janë kryer janë kryer në kuadër të çmimit të lartcekur edhe pse në teren në kemi kryer punë edhe më shumë se sa ky çmim. Pranimin teknik të punëve të kryera e bënë një komision i përbërë prej tre zyrtarëve dhe ata kanë konstatuar se dokumentacioni dhe punët që janë kryer në teren kanë qenë në rregull. Kur është bërë pagesa e mjeteve, nuk kanë ndonjë vërejtje nga MPMS, bile të njëjtit ju kanë thënë se shfrytëzoni të gjitha këto mjete dhe pagesa e këtyre mjeteve është bërë nga MPMS. Përveç tjerash, ky projekt ka qenë i monitoruar edhe nga IOM-i. I akuzuari A. K. i ka kryer të gjitha punët, ashtu siç kanë qenë të parapara me projekt bile ka kryer edhe me punime shpesh, të cilat nuk i janë paguar fare. Nuk është e vërtetë se i akuzuari A. ka bërë paraqitje të situacioneve të rreme të punimeve, që do të thotë se i njëjti nuk e ka bërë rritjen e punimeve në kundërshtim me paralogaritjen në paramasë. Për punën të cilën e ka kryer i akuzuari I. TH. i njëjti ka përpiluar raport me shkrim dhe përveç kësaj, i njëjti më datën ...2011, e ka nënshkruar edhe në raportin përfundimtar, i cili raport edhe është përpunuar me gjendjen faktike gjë që edhe është lejuar pagesa përfundimtare.

3.3.4. I akuzuari A. K., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor, e ka mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar dhe ka shtuar e me kompaninë e tij “...” e ka fituar tenderin për pastrimin e lumit “...”. Sipas kontratës punët kanë qenë të parapara me njësi dhe shumica e punimeve janë llogaritur me metër katror. Të gjitha punët janë kryer në tërësi, ashtu siç është e paraparë dhe kanë qenë në harmoni me situacionet, si dhe gjithashtu, për punët e kryera ka pranuar çmimin. Të gjitha punimet që janë kryer janë paraqitur në dokumentacionin përkatës dhe e ka mohuar faktin se ka paraqitë situacione të rreme të punimeve.

4. Elementet e veprave penale

Në nenin 422 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, e kryen “personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitojë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t’i shkel të drejtat e personit tjetër” dhe për këtë veprë penale është parashikuar dënimi me burgim prej 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet. Në nenin 426 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar forma themelore e veprës penale mashtrimi në detyrë, të cilën e kryen “personi zyrtar, i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, bën prezantimin e rremë të raportit të llogarive apo në ndonjë mënyrë tjetër e vë në lajthim personin e autorizuar në kryerjen e pagesës së kundërligjshme” dhe për këtë formë të kësaj veprë penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet. Ndërsa, në paragrafin 2 të këtij neni është parashikuar forma e rëndë e kësaj veprë penale, e cila konsiderohet se është kryer nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore në vlerë që tejkalon 5.000 Euro, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej 1 (një) deri në 8 (tetë) vjet. Kurse, në nenin 290 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të KPRK, është parashikuar se këtë formë të veprës penale keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi, e kryen “personi pergjegjes që gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike kryen një nga veprimet në vijim me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për ndonjë person tjetër, përmes përpilimit të dokumenteve me përmbajtje të rreme, me bilance të rreme, me vlerësime të rreme, inventarizim apo me prezantim tjetër të rremë ose përmes fshehjes së provave në mënyrë të rreme e prezantant qarkullimin e aseteve ose të rezultateve të veprimtarisë ekonomike dhe në këtë mënyrë i vë në lajthim organet drejtuese në organizatën e biznesit gjatë vendimarrjes lidhur me veprimtaritë menaxhuese. Për këtë formë të kësaj veprë penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet.

5. Vlerësimi dhe anA. zimi i provave

Trupi gjykues pas anA. zimit me shumë kujdes të gjitha provave të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se duhet t’i falet besimi i plotë deklarimeve të akuzuarve Sh. S., S. TH. I. TH. dhe A. K., të cilët e mohuar kryerjen e veprave penale për të cilat janë akuzuar. Trupi gjykues ja ka falur besimin e plotë deklaramit të akuzuarve, për shkak se këto deklarime, në pari janë në harmoni në mes vete, kurse në anën tjetër gjejnë mbështetje edhe në provat materiale të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor. Përveç këtyre, deklaramet e të akuzuarve, në përgjithësi, janë në harmoni edhe me deklaramet e tyre, të dhëna në procedurën e hetimeve, gjë që ia rritë edhe më shumë vlerën besueshmërisë së këtyre deklarimeve.

Siç është cekur më parë, për të ekzistuar veprat penale për të cilat janë akuzuar të akuzuarit Sh. S., S. TH. dhe I. TH. duhet që veprimet e kryerjes së veprave penale të ndërmerren me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për vete ose për personin tjetër. Ky qëllim është esencial, çka do të thotë se pa ekzistimin e këtij qëllim nuk mund të ketë as veprë penale. Duke ju referuar kësaj pike, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se këtë çështje penale, absolutisht nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme se të akuzuarit Sh. S., S. TH. dhe I. TH. të kenë ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim që vetit ose Operatorit Ekonomik “...” t’i sjellin dobi pasurore të kundërligjshme. Kjo për faktin se nuk është vërtetuar ndonjë lidhje e caktuar në mes të akuzuarve në këtë çështje; se të gjitha të hollat janë paguar përmes llogarive bankare dhe këta të akuzuar nuk kanë patur qasje; se siç është cekur edhe më parë, si rezultat i këtij projekti janë punësuar një numër i konsiderueshëm i punëtorëve që kanë përfituar ndihmë sociale, e të cilët konsiderohen se në një mënyrë edhe janë përfitues të këtij projekti, etj. Kur është fjala për dispozitivin III të aktakuzës – vepra penale mashtrimi në detyrë, për të cilën akuzohet I. TH. prokurori i shtetit, nuk e ka cekur fare “qëllimin e kryerësit” e që sipas dispozitës së lartcekur ligjore, ky qëllim është element esencial i veprës penale dhe pa këtë qëllim nuk mund të ketë veprë penale. Por, edhe përkundër kësaj, edhe sikur të ceket ky element “qëllimi”, siç është cekur edhe më lart, me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar ky qëllim i lartcekur i të akuzuarit I. TH..

Në anën tjetër, nga provat që janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se tenderi për Pastrimin “...” është shpallur me njësi dhe duke u bazuar në këtë kriter, komisioni për vlerësimin e ofertave e ka rekomanduar Operatorin Ekonomik “...” që të jetë fitues i këtij tenderi. Nga provat materiale, është vërtetuar se për tenderin e lartcekur kanë aplikuar pesë tenderues të përgjegjshëm dhe atë :

1. NTP “...”- çmimi i shumës për njësi prej 303.86 Euro;
2. KNPSH “...”- çmimi i shumës për njësi prej 307.28 Euro;
3. “...” SHPK- çmimi i shumës për njësi prej 314.36 Euro;
4. SHPK “...”- çmimi i shumës për njësi prej 422.35 Euro dhe
5. “...” - çmimi i shumës për njësi prej 455.59 Euro.

Nga kjo listë e kompanive që kanë aplikuar, shihet se Operatori ekonomik NTP “...” pronar i së cilës është i akuzuari A. K., ka ofertuar me çmimin më të lirë për njësi, se ofertuesit tjerë dhe oferta e tij ka qenë 303.86 Euro për njësi, ndërsa ofertuesit tjerë kanë ofertuar më një çmim më të lartë. Ky çmim i ofertuesit NTP “...” është konsideruar si çmimi më i volitshëm dhe i njëjti ka qenë vendimtar për përzgjedhjen e këtij ofertuesi. Duke u bazuar në këtë çmim më të lirë të Operatorit Ekonomik NTP “...” komisioni për vlerësimin e ofertave, e kishte rekomanduar që ky ofertues edhe të jetë fitues i këtij tenderi. Mirëpo, me arsyetimin se komisioni për vlerësimin e ofertave nuk ka qenë i formuar nga kryetari i komunës, ... i atëhershëm i Komunës së K., tani i akuzuari Sh. S., e kishte anuluar këtë tender. Ndaj këtij anulimi të tenderit, ishte ankuar operatori ekonomik NTP “...” dhe Paneli Shqyrtues i Prokurimit, me vendimin PSH.nr.232/11, të datës ...2011, e kishte aprovuar si të bazuar ankesën e Operatorit Ekonomik “...” me ç’rast edhe e kishte anuluar vendimin e datës ...2011, të Komunës së Kamenicës, mbi njoftimin e anulimit të aktivitetit të prokurimit Pastrimi “...” në Kamenicë. Pas kësaj, Komisioni për vlerësimin të tenderëve, i përbërë prej M. Th., B. D. dhe Sh. M., përsëri e kishin rekomanduar që ofertuesi NTP “...” të shpërblehet me kontratë dhe kriter për dhënien e kontratës ka qenë “çmimi më i ulët për njësi”.

Pra, nga kjo shihet se dy komisione të ndryshme, njëri i përbërë nga H. R., N. R. dhe A. B., kurse, tjetri i përbërë nga M. Th., B. D. dhe Sh.M., kishin rekomanduar që operatori ekonomik NTP “...” të jetë fitues i këtij tenderi, për shkak se ka ofertuar me çmimin më të lirë për njësi dhe ky çmim për njësi, ka qenë i përcaktuar edhe në tenderin që është shpallur. Në anën tjetër, edhe vetë Paneli Shqyrtues i Prokurimit, e cila në njëfarë mënyrë konsiderohet si një “gjykatë e tenderëve” e kishte aprovuar si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik NTP “...” duke kërkuar që të vazhdohet procedura e vlerësimin të ofertuesve. Pasi që është rekomanduar për herë të dytë, që fitues i këtij tenderi të jetë operatori ekonomik NTP “...” nuk ka patur mund të kalohet shuma prej 145,000.00 Euro dhe çmimi për njësi do të jetë prej 303.80 Euro. Në anën tjetër, nuk është respektuar procedura përkatëse ligjore, ngase kriter për dhënien e kontratës ka qenë “çmimi më i ulët për njësi”, e jo siç është cekur në ekspertizën e ekspertit R. B. çmimi si total.

Duke u bazuar në të gjitha këto, edhe është lidhur kontrata në mes të Komunës së Kamenicës dhe operatorit ekonomik NTP “...”. Nëse anA. zohet më vëmendje kjo Kontratë, aty shihet se çmimi i kësaj kontrate është “çmim i planifikuar”, ndërsa çmimi i ofertës për njësi është 303,80 Euro. Kjo do të thotë se çmimi i kontratës, nuk ka qenë çmim fikse, por ka qenë çmim “fleksibil” e që i bie që sa të punohet me njësi, aq edhe do të paguhet. Por, ajo çka është e rëndësishme, që nuk mund të kalohet shuma prej 145,000.00 Euro dhe çmimi për njësi do të jetë prej 303.80 Euro. Në anën tjetër, nuk duhet lënë pa e përmendur edhe njëherë, se çmimi për njësi prej 303.80 Euro, i ofertuar nga operatori ekonomik NTP “...”, ka qenë çmimi më i ulët, nga të gjithë operatorët tjerë.

Në anën tjetër, nga raporti përfundimtar i Organit Mbikëqyrës, i cili përbehej prej z.I. Th. dhe z.Sh. M., ishte konstatuar se Operatori ekonomik “...”, i kishte kryer punët sipas paramasës dhe parallogarisë, kurse, nga procesverbA. i Komisionit për kontrollimin dhe pranimin teknik, i përbërë prej E. I., Z. Th. dhe L. K., është konstatuar se punimet janë kryer sipas kërkesave në dokumentacionin teknik dhe kontratës. Ku si rezultat i kësaj, edhe është bërë pranimi teknik sipas dokumentacionit teknik (paramasës dhe parallogarisë), duke e bërë edhe verifikimin në teren (vendin e ngjarjes).

Duke u bazuar në të gjitha këto që u cekën më lartë, trupi gjyqësor, ka ardhur në përfundim, absolutisht nuk kemi kurrfarë dëmtimi të buxhetit të Republikës së Kosovës, për shkak se operatori ekonomik NTP “...” i ka kryer të gjitha punët sipas paramasës dhe parallogarisë, ku si rezultat i kësaj është paguar për shumën, për sa edhe ka kryer punë. Në anën tjetër, është i pabazuar pretendimi i prokurorit të shtetit që në këtë tender ka patur ngritje të vëllimit të punimeve, për shkak se të gjitha punimet kanë qenë të përcaktuara me njësi dhe sa ka patur nevojë (në kuadër të çmimit prej 145,000.00 Euro), edhe është punuar. Po ashtu, duke u bazuar në provat e cekura më lart, siç janë deklarami i të akuzuarve dhe provat materiale, nuk është vërtetuar se i akuzuari A. K., ka bërë paraqitje të re me të situacioneve. Në kontekst, të veprimeve inkriminuese të të akuzuarit I. TH. trupi gjyqësor ka konstatuar se i njëjti nuk ka patur nevojë që të paraqet nevoja shtesë të punëve, ngase punët janë kryer duke u bazuar në “njësi”.

Kur është fjala për ekspertizën e ekspertit R. B. trupi gjyqësor të njëjtën e ka vlerësuar, si një provë në kuadër të shumë provave, edhe pse i njëjti këtë ekspertizë e ka bërë pa dalë në vendin e ngjarjes dhe në të janë përmendur emrat e të akuzuarve dhe të disa personave tjerë, si persona që janë të involvuar në këtë proces tenderik. Nuk i është falur besimi, konstatimit të këtij eksperti, se në këtë rast, kemi patur dëm për buxhetin e Republikës së Kosovës, për arsyet që janë cekur më lartë. Kjo për faktin se edhe vetë, në ekspertizën e tij, e cekë, se kriter për dhënien e kontratës ka qenë “çmimi për njësi”.

Në fund, trupi gjyqësor, pas anA. zimit dhe vlerësimin të të gjitha provave ka konstatuar se :

- nuk është vërtetuar se të akuzuarit Sh. S., S. TH. dhe I. TH. të kenë ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim që vetit ose Operatorit Ekonomik “...” t’i sjellin dobi pasurore të kundërligjshme;
- se është respektuar procedura ligjore e dhënies së tenderit, për shkak se kriter bazë, ka qenë “çmimi për njësi”;
- se nuk është vërtetuar se të akuzuarit Sh. S. dhe S. TH. me rastin e implementimit të punimeve, kanë lejuar ngritjen e vëllimit të punimeve, për shkak se edhe nuk ka patur nevojë për një gjë të tillë, ngase punët janë kryer, duke u bazuar në “njësi” dhe
- se nuk është vërtetuar se është dëmtuar buxheti i Republikës së Kosovës, siç pretendohet në aktakuzë, për shkak se operatori ekonomik NTP “...” duke u bazuar në çmimin për njësi ka kryer punë, të cilat i korrespondojnë shumës prej 145,000.00 Euro.

6. Vendimi për lirimin e të akuzuarit nga akuzat

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në nenin 364, paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPP, trupi gjykues i liroi nga akuza të akuzuarit Sh. S., S. TH. I. TH. dhe A. K., për kryerjen e veprave penale, siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

7.Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë duke u bazuar nenin 454 paragrafi 1 të KPP.

Duke u bazuar në arsyet që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 13.11.2015

Sekretarja juridike,
Fikrete Destani

Kryetari i trupit gjykues,
Afrim Shala

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.